

“POLITIKAT E ZGJERIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN DREJT
BALLKANIT PERËNDIMOR NË RRETHANAT E ‘LODHJES SË
ZGJERIMIT’ DHE EUROSKEPTICIZMIT BREND A ANËTARËVE TË TIJ”

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË INTEGRIME EVROPIANE DHE
ADMINISTRATË PUBLIKE

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

nga

SHAKE HOXHAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

Prishtinë, 2022

ABSTRAKTI

“POLITIKAT E ZGJERIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN DREJT BALLKANIT PERËNDIMOR NË RRETHANAT E ‘LODHJES SË ZGJERIMIT’ DHE EUROSKEPTICIZMIT BRENDA ANËTARËVE TË TIJ”

nga

Shake Hoxhaj

Mentor: Prof. Asoc. Dr., Bardhok Bashota

Zgjerimi i Bashkimit Evropian historikisht ka kaluar nëpër procedura dhe ngjarje të ndryshme të cilat detyrimisht janë përcjellë me pakënaqësi të shumta edhe mes anëtarëve të vetë BE-së. Zgjerimi drejtë Ballkanit Perëndimor si një nga rajonet ndoshta më strategjike të Evropës është përcjellë me një mori zhvillimesh, që nga aspekti i vet politikave dhe ngjarjeve që prodhon ky rajon e deri tek skepticizmi i pranimit si tërësi e modeleve të ndryshme demokratike brenda Unionit. Zgjerimit e mëparshme kanë nxjerre në pah probleme të ndryshme brenda Unionit, situata këto që po ndikojnë direkt në procesin e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, lodhja nga problemet që kanë shkaktuar këto zgjerime kanë filluar ta zbehin opinionin e përgjithshëm brenda Unionit, shtu këtu edhe faktin e rritjes së qëndrimeve euroskeptike unë kam paraqitur rrugën dhe situatën aktuale të vendeve të BP drejtë anëtarësimit në BE.

Gjatë punimit jemi ndalur në faktet e mëparshme të zgjerimit dhe ndikimin e tyre, kam paraqitur opinionin e përgjithshëm kundrejt BE-së, si dhe situatën aktuale euroskeptike. Gjithashtu kam paraqitur statusin aktual të vendeve të BP drejtë anëtarësimit në BE.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një ngecje drejtë anëtarësimit në BE, kjo si shkak i vetë politikave strikte të vendosura nga BE-ja dhe opinionit të shteteve anëtare të BE-së që kanë zhvilluar një euroskepticizem të paparë deri më tani. Këto situata përkundër procesit pozitiv drejtë anëtarësimit shihen si pengesat kryesore në zgjerimin e BE-së drejt Ballkanit Perëndimor.

PËRBËRJA/ARKITEKTURA E PUNIMIT

Në rrafshin strukturor, ky studim është organizuar në katër kapituj dhe titujt brenda tyre.

Para se të filloj me kapitujt kam bërë një pasqyrë hyrëse të studimit, qëllimin e punimit, kam treguar për metodologjinë e përdorur gjatë punimit, hipotezat e studimit si dhe pyetjen hulumtuese.

Në kapitullin e parë- fillimisht janë paraqitur vështrimet gjenealogjike të zgjerimit të Bashkimit evropian duke paraqitur teoritë e integrimi evropiane, pastaj strategjitë e zgjerimit të BE-së drejt Evropës Qendrore, Lindore si dhe politikat e zgjerimit drejt Evropës Juglindore me theks drejt shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Në kapitullin e dytë - kam diskutuar procesin e zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor, duke shqyrtuar në veçanti hapjen e perspektives Evropiane për shtetet e Ballkanit Perëndimor, pastaj jam ndalur tek nevoja e shtrirjes gjeografike të BE-së si një proces me interes të veçantë të shtrirjes në Ballkanin Perëndimor pasi që paraqet një nga rajonet më gjeostrategjike në Evropë, nga i gjithë prezantimi në këtë kapitull kam diskutuar edhe efektin e lodhjes nga zgjerimet paraprake që mund të kenë në zgjerimin e Bashkimit Evropian drejt Ballkanit Perëndimor.

Në kapitullin e tretë- pas shtjellimeve paraprakë të lodhjes nga zgjerimi brenda BE-së jam ndalur konkretisht tek efekti i zgjerimit të madhe në BE i njohur ndryshe si zgjerimi ‘bing bang’ efektin që ka përcjell ky zgjerim për zhvillimet e mëtutjeshme brenda Unionit, si dhe ndikimin e këtij zgjerimi në prioritetet e BE-së drejt zgjerimit në Ballkanin Perëndimor, gjithashtu në këtë kapitull kam elaboruar edhe efektin e krizës në eurozonë, krizën e emigrantëve në vitet e fundit si dhe luftën kundër terrorizmit në vendet e BE-së si dhe në vendet Evropiane jo anëtare të Unionit.

Në kapitullin e katërt – Në këtë kapitull pasqyrohet perspektiva e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor në kushtet e euro-skepticizmit që janë prezent brenda anëtarëve të BE-së, do paraqesim politikat e BE-së për zgjerim në drejtim të këtij rajoni në kushtet e euro-skepticizmit, pastaj qëndrimet e shteteve anëtare kundrejt këtij rajoni, sfidat që kanë shtetet e rajonit për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në BE, si dhe efektin pandemik të Covid-19 brenda BE-

së në orientimin dhe zhvillimin e politikave të zgjerimit, e krejt në fund kam paraqitur pozicionin aktual të shteteve të Ballkanit Perëndimor drejt afrimit dhe anëtarësimit në BE.

Përfundimet dhe Konkluzionet në fund të punimit në bazë të literaturës së shfletuar dhe materialit të shtjelluar gjatë punimit kam paraqitur përfundimet dhe konkluzionet, në bazë të së cilave do shfaqim faktet dhe elementet që do të ndikonin në zgjerimin e BE-së drejt Ballkanit Perëndimor, duke theksuar këtu lodhjen nga zgjerimi dhe euro-skepticizmin, por duke mos harruar edhe të kaluarën e Ballkanit Perëndimor dhe strukturën e ngjarjet politike e ekonomike të tanishme.

HIPOTEZAT DHE PYETJA HULUMTUESE

Hipotezat e ngritura të cilat jam munduar që të bëjë edhe testimin gjatë punimit me qëllim për të arritur objektivat e hulumtimit janë:

H1 – *Bashkimi Evropian si një bashkim politik dhe ekonomik i vendeve anëtare, ka për qëllim shtrirjen në të gjithë Evropën;*

H2 – *Euroskepticizmi mbetet problem për zgjerimin e mëtutjeshëm të BE-së;*

H3 – *Politika e barazisë ndër shtetërore dhe hapja e kufijve ndërmjet vendeve anëtare të BE-së, me qëllim të krijimit të një sistemi unik ekonomik e shoqëror pa dëmtuar aspektin nacional është prioritet i BE-së;*

H4 – *Bashkimi Evropian përkundër interesit të shteteve të Ballkanit Perëndimor për anëtarësimin e tyre në BE, përsëri mbetet skeptike përmes politikave të ndryshme drejt zgjerimit të tij në Ballkanin Perëndimor.*

Përveç Hipotezave të punimit të paraqitura më lartë, dhe më qëllim të arritjes sa më të saktë të rezultateve gjatë hulumtimit, kam paraqitur edhe pyetjen hulumtuese:

Pyetja hulumtuese: *Bazuar në zgjerimet paraprake dhe euro-skepticizmin që po mbizotëron në BE, cila është perspektiva e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor?*